

platforma

CiviKos

ANALIZË

**VULLNETARIZËM PËR
ZHVILLIM**

*ZHVILLIMI I KORNIZËS
LIGJORE PËR NJOHJEN DHE
PROMOVIMIN E
VULLNETARIZMIT NË
KOSOVË*

Autor:
Hajrulla Çeku

2013 Platforma CiviKos

Pikëpamjet e shprehura në
këtë botim nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht pikëpamjet
e Platformës CiviKos

Publikuar nga:
Platforma CiviKos
Rruga Fazli Grajqevci 4/A
10000 Prishtinë
Kosovë



Për më shumë informata:
info@civikos.net
www.civikos.net

Përmbajtja

1. Përmbledhje	3
2. I. PSE VULLNTARIZËM	4
2.1. Koncepti i vullnetarizmit	4
2.2. Vullnetarizmi dhe Aktivizmi shoqëror	5
2.3. Efektet pozitive	6
2.4. Arritja e Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit	6
2.5. Zhvillimi ekonomik	7
2.6. Menaxhimi i fatkeqësive	7
2.7. Ndërtimi i paqes	7
3. II. LIGJET DHE POLITIKAT	8
3.1. Praktikat botërore	8
3.2. Raste studimi	10
3.3. Italia	10
3.4. Gjermania	11
3.5. Britania e Madhe	11
Iniciativat rajonale dhe globale	11
4. III. SUGJERIME PRAKTIKE	13
4.1. Politikat dhe legjislacioni	13
4.2. Identifikimi i qëllimeve dhe sfidave	14
4.3. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	15
4.5. Hartimi i ligjeve/politikave	15
4.6. Zbatimi i ligjeve/politikave	16

Përmbledhje

Kjo analizë e shkurtër sjell argumente praktike dhe modele të aplikueshme të vullnetarizmit. Ajo është e strukturuar në dy nivele: politikat e venojshme dhe mobilizimi shoqëror. Promovimi dhe aplikimi i punës vullnetare është veprim i koordinuar i sektorëve relevantë të një shoqërie, ku shteti, shoqëria civile, bizneset dhe familja janë në përthamëen e tij. Kosova ka një periudhë të ndritshme të mobilizimit shoqëror (solidariteti dhe vullnetarizmi) gjatë viteve të 90-a. Kjo praktikë nuk është treguar e qëndrueshme edhe në vitet e pas-luftës. Shkaqet themelore të kësaj shkëputjeje janë: konteksti i ri politik dhe shoqëror (largimi i okupatorit), besimi se shteti duhet të jetë përgjegjës i vetëm për mirëqenien shoqërore, mungesa e politikave dhe legjislacionit adekuat, deri te aplikimi agresiv i parimeve të tregut të lirë (kapitalizmit) në një ekonomi të shkatërruar post-konflikt. Ky degradim i punës vullnetare ka ndikuar në dëmtimin e substancës së kapitalit shoqëror të qytetarëve të Kosovës. Prandaj, pjesa e fundit e kësaj analize ofron sugjerime praktike për konsolidimin e vullnetit institucional dhe shoqëror për punën vullnetare në Kosovë.

Analiza është e ndarë në katër pjesë:

- 1. Pse Vullnetarizëm (Koncepti i vullnetarizmit, Vullnetarizmi dhe Aktivizmi shoqëror, Efektet pozitive) – zbërthim i konceptit teorik të vullnetarizmit, me fokus në ndërlidhjen mes punës vullnetare dhe qëllimit përfundimtar të saj, mobilizimin e shoqërisë. Në veçanti, shtjellim i efekteve konkrete që ka vullnetarizmi në cilësinë e jetesës së qytetarëve (ekonomia, asistenca sociale, shërbimet publike, kultura, etj.)*
- 2. Ligjet dhe Politikat (Praktikat botërore, Raste studimi, Iniciativat rajonale dhe globale) – paraqitje e praktikave të suksesshme botërore mbi vullnetarizmin, duke i shikuar veprimet konkrete të shteteve me përvojë në promovimin dhe aplikimin e punës vullnetare (Britania e Madhe, Italia, Polonia, Amerika Latine, etj.). Kapitulli përmbillet me paraqitjen e iniciativave për promovimin e vullnetarizmit në kuadër të organizatave globale dhe rajonale (Kombet e Bashuara, Bashkimi Evropian, etj.)*
- 3. Vullnetarizmi në Kosovë (Vitet e 90-a, Pas vitit 1999, Raste konkrete) – analizë krahasuese e dy periudhave mjaft kundërthënëse mes veti kur bëhet fjalë për vullnetarizmin në shoqërinë e Kosovës. Shtjellim i shkaqeve që kanë ndikuar në degradimin e punës vullnetare në vitet e pas-luftës në krahasim me mobilizimin e përgjithshëm shoqëror të viteve të 90-a. Kapitulli do të paraqesë edhe disa raste konkrete të punës vullnetare në Kosovë, të cilat kanë treguar konsistencë përgjatë dy dekadave të fundit.*
- 4. Sugjerime praktike (Politikat dhe legjislacioni, Roli i aktorëve relevantë, Niveli individual i veprimit) – bazuar në praktikat botërore, kapitulli i fundit ofron sugjerime praktike për përpilimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit adekuat për vullnetarizëm. Në këtë kuadër, do të analizohet roli i secilit aktor relevant për veprim të koordinuar në promovimin dhe përhapjen e vullnetarizmit në Kosovë.*

I. PSE VULLNETARIZËM

Koncepti i vullnetarizmit

Në përgjithësi dhe parimisht vullnetarizmi është praktika e punës së njerëzve, të cilët punojnë për të tjerët pa qenë të motivuar nga përfitimet financiare apo materiale. Vullnetarizmi kryesisht lidhet me një veprimtari altruiste, që ka për qëllim promovimin e cilësisë më të lartë jetësore për njerëzit. Njerëzit poashtu marrin pjesë në punë dhe aktivitete vullnetare për të përfituar shkathtësi të reja pa patur nevojën e investimeve financiare të punëdhënësit. Vullnetarizmi mund të ketë forma të ndryshme dhe ushtrohet nga grupe të ndryshme njerëzish. Shumë vullnetarë janë të trajnuar në veçanti mbi fushën ku veprojnë, si psh. në mjekësi, arsim apo shpëtim emergjent. Të tjerët marrin pjesë në punë dhe aktivitete vullnetare në bazë të nevojës dhe kërkesës, si psh. duke reaguar ndaj një katastrofe natyrore.

Përveç tjerash dhe në parim, njihen tre përfitime të përgjithshme të punës vullnetare (vullnetarizmit): [a] përfitimi ekonomik: aktivitetet që ndërmerren nga vullnetarë, në kushte normale do të duhej të financoheshin nga fondet shtetërore apo private. Vullnetarizmi ndihmon në rezultatet e përgjithshme ekonomike të një shteti dhe zvogëlon ngarkesën mbi shpenzimet qeveritare, [b] përfitimi shoqëror: vullnetarizmi ndihmon ndërtimin e komuniteteve më kohesive, duke nxitur besim më të madh në mes të qytetarëve dhe duke zhvilluar norma të soliaritetit dhe reciprocitetit, të cilat janë qenësore për komunitete stabile dhe [c] përfitimi individual (karrieristik): të diplomuarit mund të takojnë njerëz të ndryshëm dhe më përfitojnë përvoja të reja përmes punës dhe aktivitetit vullnetar. Në anën tjetër, vullnetarizmi u ndihmon nxënësve të shkollave për një bursë studimore, duke e ditur rëndësinë e punës vullnetare brenda CV-së.

Fjala angleze vullnetarë fillimisht kuptohej si një ushtar oportunist në një ushtri mesjetare, duke u formuar ngadalë gjatë shekujve në qytetarë të mirë që ne i dijmë dhe i duam. Gjuhësia si dhe koncepti ligjore mund të jenë konfuze, sektori i vullnetarëve është duke u rritur në menaxhimin e profesionistëve, dhe shumë vullnetarë duke punuar përtej detit paguhen duke u bazuar në nivelin lokal, ndërsa tjerë janë të lutur të paguajnë për disa privilegje. Fatmirësisht imazhi global i vullnetarizmit ka ndriçuar ndërmjet këtyre varianteve në interpretimet e tyre; vullnetarët janë të përhapur gjerësisht me kohezionin e komuniteteve lokale, duke hedhur poshtë luhatjet e programeve nacionale të mirqënies dhe madje duke çimentuar suksesin e lojrave olimpike të Sidneit. Ka me të vërtetë shumë optimizëm në lidhje me fushat e reja të të qenurit vullnetarë që sjell potencialin e zgjerimeve të këtyre sukseseve lokale në fshatin global.

Nocioni i vullnetarizmit konceptohet dhe vlerësohet në mënyra të ndryshme nëpër botë. Për shembull, Indeksi i Shoqërisë Civile i Guinea-s vullnetarizmin e definon si “ndihmë një fqiu apo një anëtar të komunitetit pa pritshmërinë e kompensimit material”, derisa raporti i Jordanisë e elaboron “vullnetarizmin si një obligim kombëtar... një obligim fetar... dhe një mënyrë për të gjetur një punë”. Në Shqipëri, vullnetarizmi shihet negativisht për shkak të punës së detyrueshme vullnetare nën diktaturën e komunizmit, derisa në Armeni “akti i vullnetarizmit nënkupton ofrimin e shërbimeve, organizimin e veprimit politik, përkujdesjen ndaj të varfërve, ndihmën ndaj navojtarëve, ofrimin e arsimit, sigurimin e barazisë dhe të drejtave civile për të gjithë qytetarët dhe në përgjithësi punën për ndryshim.

Raporti i Civikus dhe UN Volunteers për mësimet e nxjerra nga viti 2011 mbi vullnetarizmin bën një klasifikim të përgjithshëm të vullnetarizmit në formal dhe joformal. Sipas raportit, vullnetarizmi formal nënkupton punën vullnetare të realizuar në patronatin e organizatave formale që angazhojnë vullnetarë, që mund të jenë OshC, entitete publike ose private – ose me fjalë të tjera vullnetarizëm i bazuar në organizatë. Raporti specifikon se ky lloj i vullnetarizmit është i planifikuar dhe i strukturuar, ku vullnetari zykonisht vepron në bazë të direktivave, rregullave dhe standardeve të organizatës. Ajo/ai në këtë ras nuk është i/e pavarur, por vepron brenda strukturave dhe përmbush misionin e organizatës. Në anën tjetër, vullnetarizmi joformal është një grup i veprimeve dhe përfshirjes që ekziston në mbarë botën, por shpesh pa mirënjohje dhe vlerësim. Ky lloj i vullnetarizmit i referohet një spektri të aktiviteteve vullnetare që ndërmerren jashtë organizatave formale, atëherë kur njerëzit veprojnë si individë ose grupe, si në baza të përkohshme ashtu edhe në baza të përhershme. Vullnetarizmi joformal mund, për shembull, të ngjajë brenda një komuniteti të lagjes ose fetar, përmes medias sociale në internet, ose në protesta spontane, por që nuk lidhet drejtpërdrejtë me, ose nuk bëhet në emër të një organizate formale. Përvoja vullnetare nëpër botë na tregon se kjo është forma më e përhapur dhe e pëlqyer e vullnetarizmit.

Vullnetarizmi dhe Aktivizmi shoqëror

Një nga kategorizimet e vullnetarizmit është edhe ai që punën vullnetare e ndaj në katër grupe: ndihmë e dyanshme ose vetë-ndihmë, filantropi ose shërbim të tjerëve, pjesëmarrje qytetare dhe avokim ose kampanjë. Shikuar në këtë mënyrë, vullnetarizmi përfshin një numër të madh veprimesh, si pjesëmarrje në një grup përkrahës për personat me HIV/AIDS, organizim i ngjarjeve për ngritje findesh, shpërndarje e ushqimit dhe batanijeve pas katastrofave natyrore, përfshirje në planifikimin zhvillimor lokal dhe fushatë kundër dhunës gjinore. Megjithatë, kjo gjerësi veprimesh është karakteristike edhe për aktivizmin, i cili shpesh acociohet me strategjitë sikur lobimi, avokimi, negociimi, protesta, fushata dhe ngritja e vetëdijes. Ky pikëtakim në natyrën dhe qëllimin e vullnetarizmit dhe aktivizmit na sugjeron mbi mundësinë e një raporti dinamik mes këtyre dy sferave të veprimit.

Megjithatë, ende ka dyshim në mesin e shoqërisë civile, qeverisë dhe sektorit të biznesit rreth asociimit të vullnetarizmit me aktivizmin. Në fakt, vullnetarizmi dhe aktivizmi ndonjëherë kuptohen si dy veprime të ndryshme me qëllime dhe interesa specifike. Të kuptuarit e vullnetarizmit dhe aktivizmit si sfera të ndara ka ndikuar në devaluimin e të dyja koncepteve. Në disa vende, vullnetarizmi tradicional është kritikuar për, siç është thënë, të ketë sjellë më shumë dëme sesa dobi, si pasojë e largimit të vëmendjes dhe burimeve nga arsyt kyçe të problemeve, siç janë varfëria dhe pabarazia. Kjo ka krijuar edhe bindjen se vullnetarizmi pengon aktivizmin politik, duke penguar mundësitë e ndryshimeve të nevojshme strukturore. Një botëkuptim i ngjashëm dhe i ngushtë ekziston edhe për aktivizmin, i cili në disa raste shihet si diçka elitiste dhe jorelevante për problemet ekzistenciale, dhe që lidhet me trazimin e publikut, deri edhe me dhunën.

Por, a është ky botëkuptim i polarizuar mbi vullnetarizmin dhe aktivizmin një reflektim i saktë i realitetit dhe diversitetit të njerëzve që marrin pjesë në aktivitete që potencialisht përkojnë me secilën nga këto dy botëkuptime/etiketime? Nëse vullnetarizmi përmban në vete aktivitete si avokimi, fushata dhe pjesëmarrje qytetare, a nuk pasqyron kjo ngjashmëritë me aktivizmin? Dhe nëse po, a ekziston një raport i përbashkët përkrahës mes këtyre dy sferave të veprimit?

Studimet e dekadës së fundit kanë dëshmuar për shumë ngjashmëri mes vullnetarizmit dhe aktivizmit shoqëror, ndërsa tri fusha të përgjithshme të pikëtakimit të këtyre dy sferave të veprimit janë:

- Si vullnetarizmi ashtu edhe aktivizmi ndihmojnë në zhvillimin e mundësive për pjesëmarrje të njerëzve me prejardhje të ndryshme dhe nga rrethana të ndryshme. Për më tepër, që të dyja këto sfera të veprimit reflektojnë një zgjedhje personale për përfshirje në çështje të komunitetit dhe shoqërisë. Esencialisht që të dyja iu apelojnë njerëzve të ndryshëm, në momente të ndryshme, duke iu ofruar atyre një gamë të gjerë mundësish për pjesëmarrje në veprime që ndihmojnë në arritjen e ndryshimeve pozitive shoqërore,
- Që të dyja këto sfera të veprimit janë përparimtare dhe të orientuara kah ndryshimi. Edhe pse disa njerëz mendojnë se aktivizmi shoqëror është një përpjekje për ndryshim, ndërsa vullnetarët i shohin si njerëz që jo patjetër dëshirojnë thyerjen e status quo-s, megjithatë shumica mendojnë se, sikurse aktivizmi shoqëror, edhe vullnetarizmi mund të jetë përparimtar dhe i orientuar kah ndryshimi,
- Këto dy sfera të veprimit mund të shfrytëzohen si mjete për zhvillim, kryesisht për shkak të ndihmës që ofrojnë në arritjen e objektivave zhvillimore të Millenium Development Goals (Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit). Studimet tregojnë se njerëzit janë të bindur se aktivizmi shoqëror dhe vullnetarizmi i përgjigjen sfidave të mëdha zhvillimore të kohës sonë.

Efektet pozitive

Pse qeveritë duhet të jenë të motivuara për promovimin e vullnetarizmit, kur mendohet se disa aktivitete vullnetare mund të shihen edhe si sfidim i autoritetit të shtetit? Janë dy përfitime të mëdha që sjell vullnetarizmi. Së pari, përfitimi ekonomik, pasi që vullnetarizmi paraqet një ndihmë të rëndësishme ekonomike për shoqërinë. Aktivitetet që realizohen nga vullnetarët, në rastin e kundërt do të duhej të financoheshin nga shteti ose kapitali privat. Vullnetarizmi krijon vlerë të shtuar në bilancin e përgjithshëm ekonomik të një shteti dhe redukton shpenzimin qeveritar. Por, vullnetarizmi ka edhe një dimension të dytë, ndoshta më të rëndësishëm në kuptim të efekteve pozitive. Ai ndihmon në krijimin e komuniteteve të forta dhe kohesive. Vullnetarizmi rrit nivelin e besimit mes njerëzve dhe ndihmon zhvillimin e normave të solidaritetit dhe reciprocitetit, të cilat janë qenësore për komunitete stabile. Për më tepër, duke ndihmuar në ndërtimit e këtij “kapitali social”, vullnetarizmi luan rol të rëndësishëm në rigjenerimin ekonomik.

Arritja e Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit

Vullnetarizmi është qenësor në arritjen e OZhM-ve. Vullnetarët lokalë, me përkrahje adekuate, luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të shëndetësisë primare, arsimit, ujit dhe shërbimeve sanitare. Vullnetarët zakonisht kanë qasje në grupe të izoluara të shoqërisë dhe në zonat që janë veçanërisht nevojtare apo me shërbim të dobët nga shteti. Si rezultat, ata luajnë një rol të rëndësishëm në adresimin e pabarazisë dhe nxitjen e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse, nëpërmjet përfshirjes në, për shembull: shërbimet bazë për komunitetin (psh. zona të largëta), rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të komunitetit për ndryshim të sjelljes (praktikat për kujdesin mjekësor, higjienën e fëmijëve, HIV/AIDS, reduktimi i stigmës, etj), rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me shërbimet themelore për të cilat anëtarët e komunitetit kanë të drejtë në mënyrë që të rritet kërkesa për shfrytëzimin dhe shërbime cilësore, përfshirja e grupeve të marginalizuara, mobilizimi i komunitetit për mirëmbajtjen e objekteve infrastrukturore të komunitetit, etj.

Zhvillimi ekonomik

Vullnetarizmi gjithashtu ofron kontribut të rëndësishëm ekonomik. Gjetjet fillestare nga tetë vendet që kanë zbatuar Doracakun e OKB-së mbi Institucionet Jo-Profitabile, tregojnë se, duke e përfshirë vlerën e shtuar nga vullnetarët, institucionet jo-profitabile përbëjnë një vlerë mesatare prej 5 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto. Studimet e shoqërisë civile kanë zbuluar se vullnetarët në vendet në zhvillim dhe në tranzicion përbëjnë 0.7% të popullatës ekonomikisht aktive dhe vullnetarët përbëjnë 37.2% e forcës punëtore të shoqërisë civile. Përveç përfitimeve të drejtëpërdrejta ekonomike të komunitetit nga puna vullnetare, studimet dëshmojnë edhe për përfitime të konsiderueshme indirekte nga vullnetarizmi përmes gjenerimit të kapitalit social. Ekzistojnë dëshmi të shumta se zhvillimi i kapitalit social është qenësor për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Studimet sugjerojnë se si kapitali social në rritje brenda një komuniteti, redukton ndjeshëm krimin dhe nivelin e vdekshmërisë, derisa rrit nivelin arsimor dhe të ardhurat familjare.

Menaxhimi i fatkeqësive

Fatkeqësitë natyrore janë një kërcënim permanent për perspektivat zhvillimore të shteteve. Ndërsa përpjekjet humanitare janë të rëndësishme, ekziston një nevojë urgjente për të reduktuar dobësitë e popullatave me rrezikshmëri të lartë të fatkeqësive dhe për të ndërtuar kapacitetet e tyre për t'i bërë ballë fatkeqësive të mundshme. Korniza Hyogo për Veprim në Konferencën Botërore 2005 për Reduktimin e Katastrofave ka njohur kontributin e vullnetarëve në administrimin e rrezikut të katastrofave. Vullnetarizmi mund të luan një rol të rëndësishëm përmes përfshirjes në: vlerësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të qeverive lokale për uljen e rrezikut të katastrofave, përpjekjet për të reduktuar dobësitë e vendeve të varfra për ballafaqim me fatkeqësitë dhe mobilizimin e komunitetit për ndërtimin e vetëdijes dhe kapacitetit për të përballuar një fatkeqësi, etj.

Ndërtimi i paqes

Vullnetarët mund të jenë gjithashtu të rëndësishëm në përpjekjet për ndërtimin e paqes. Me aftësinë e tyre për t'u angazhuar drejtpërdrejt me komunitetet, vullnetarët ndihmojnë për të lehtësuar pajtimin dhe besimin mes njerëzve. Veprimet vullnetare dhe rigjenerimi i kapitalit social kanë dëshmuar të jenë pjesë esenciale e përpjekjeve për të rindërtuar jetesa në situatat post-konflikt. Për shembull, veprimet vullnetare për të mirat publike dhe rehabilitimi i infrastrukturës bazë në komunitet mund të ndihmojnë ndieshëm në konsolidimin e paqes dhe riintegrimin e të rinjve të prekur nga konflikti në komunitetet.

II. LIGJET DHE POLITIKAT

Praktikat botërore

Marrë parasysh diversitetin e vullnetarizmit, është pothuaj e pamundur që të sugjerohen modele universale për zhvillimin e tij përmes ligjeve dhe politikave. Çka funksionin në një shtet, mund të jetë kundërproduktive në një shtet tjetër, me kulturë dhe tradita të ndryshme. Vullnetarizmi është produkt i mjedisit ku ai zhvillohet dhe politika qeveritare për promovimin dhe zhvillimin e vullnetarizmit në Mbretërinë e Bashkuar ose Shtetet e Bashkuara mund të jetë e papërshtatshme për shtetet e Amerikës Latine apo Afrikës Jugore. Ky konstatim megjithatë nuk nënkupton se ne nuk mund të nxjerrim mësim dhe përvoja nga shtete të ndryshme. Shtetet në veriun e industrializuar mund të ofrojnë mësim të vlefshme për jugun në zhvillim e sipër mbi format e institucionalizuara të përkrahjes dhe zhvillimit të vullnetarizmit. Ngjashëm, modele të ndihmës së dyanshme dhe zhvillimit komunitar që i gjejmë në shtetet në zhvillim mund të ofrojnë mësim të mira për botën e zhvilluar. Ndiurma qeveritare për vullnetarizëm mund të ketë forma të ndryshme: njohje formale, fascilitim, promovim dhe mesa të veçanta.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në mënyrë specifike ka njohur rëndësinë e legjislacionit që përkrah zhvillimin dhe rritjen e vullnetarizmit dhe ka inkurajuar qeveritë shtetërore që të miratojnë masa legjislative dhe fiskale. Që nga Viti Ndërkombëtar i Vullnetarizmit më 2001, më shumë se 70 ligje ose politika janë miratuar nga shtete të ndryshme. Pasi që lidhja mes vullnetarizmit dhe zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik është bërë më e qartë, qeveritë shtetërore kanë avancuar drejt krijimit të mjediseve ligjore dhe rregullative brenda të cilëve vullnetarizmi mund të zhvillohet. Në këto ndërmarrje, qeveritë kanë treguar një kujdes të veçantë kontekstit vendor, traditave dhe kërkesave të komunitetit. Katër parime themelore janë vërejtur në këto praktika, të cilat në të shumtën e rasteve kanë qenë gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrje të qeverisë, shoqërisë civile, sektorit të biznesit dhe aktorëve tjerë:

- Përcaktimi i qëllimeve themelore të një ligji ose politike mbi vullnetarizmin dhe i sfidave/pengesave të mundshme në arritjen e këtyre qëllimeve,
- Aplikimi i një procesi pjesëmarrës dhe të hapur të analizës, hartimit dhe zbatimit,
- Hartimi i ligjeve ose politikave për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, dhe
- Sigurimi që ligjet ose politikat e reja janë duke u zbatuar në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

Qasja holistike (gjithëpërfshirëse) është në thelbin e iniciativave të suksesshme mbi vullnetarizmin. Përmes shqyrtimit dhe artikulimit të kujdesshëm të qëllimeve të ligjeve dhe politikave të vullnetarizmit, politikëbërësit do të sigurohen që iniciativat e tyre janë të synuara, me planifikim kohor, dhe të kalibruara për të arritur ndryshime të matshme. Përdorimi i qasjes pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse përgjatë analizës, hartimit dhe zbatimit ndihmon në ndërtimin e përkrahjes nga të gjithë aktorët dhe siguron që iniciativat vullnetare janë praktike dhe maksimalisht efektive.

Praktika botërore na sugjeron se janë dy qasje themelore ndaj krijimit të ligjeve dhe politikave mbi vullnetarizmin. Në qasjen e parë, qeveria e Zelandës së Re ka krijuar një “Grup Ministror” për të zhvilluar dhe imlementuar një “Plan të Veprimit” për të avokuar dhe zbatuar një numër veprimesh që do të promovojnë rëndësinë e punës vullnetare dhe do të inkurajojnë më shumë njerëz për të kryer punë vullnetare. Ky Plan i Veprimit ka siguruar edhe pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë, në rradhë të parë të shoqërisë civile dhe ka kulminuar me hartimin e Politikës Qeveritare

mbi Vullnetarizmin. Në anën tjetër, që nga viti 2003, OshC-të në Maqedoni ka avokuar për një mjedis më të përshtatshëm ligjor për vullnetarizmin. Në vitin 2005, një grup i OshC-ve ia ka prezantuar qeverisë Planin për Zhvillimin e Vullnetarizmit të Maqedoni, ku është bërë analiza e pengesave në legjislacionin vendor dhe janë sugjeruar veprime konkrete (plan i veprimit). Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale e Maqedonisë ka themeluar një Grup Ndër-Sektoral, të përbërë nga përfaqëses të Ministrive përkatëse, OshC-të dhe ekspertët ndërkombëtare për të filluar hartimin e Ligjit mbi Vullnetarizmin. Ligji përfundimisht ka hyrë në fuqi në vitin 2007 dhe Maqedonia (bashkë me Kroacinë) sot paraqesin dy shembuj të suksesshëm të krijimit të mjedisit përkrahës për vullnetarizmin në Evropën Juglindore.

Katër parimet e hartimit të legjislacionit

Gjatë dekadës së fundit të zhvillimit të ligjeve dhe politikave për të zhvilluar vullnetarizmin, janë shquar katër parime themelore për krijimin e një kornize legjislative të suksesshme: identifikimi i qëllimeve dhe sfidave/pengësive për ligjet dhe politikat mbi vullnetarizmin, aplikimi i një procesi pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës, hartimi dhe avokimi dhe zbatimi.

Hapi i parë doemos duhet të jetë hartimi i një Analizë të Nevojave, e cila përmes një procesi demokratik dhe pjesëmarrës duhet të identifikojë qëllimet dhe sfidat potenciale para hartimit të ligjeve ose politikave. Disa nga qëllimet e përbashkëta të ligjeve dhe politikave të vullnetarizmit që janë identifikuar nga shtete të ndryshme të botës janë: mobilizimi i qytetarëve për arritjen e qëllimeve zhvillimore, përkrahja e fushave prioritare të qeverisë, krijimi i mekanizmave reagues ndaj fatkeqësive, promovimi i aktivizmit qytetar dhe zhvillimi ekonomik. Ndërsa në mesin e sfidave/pengësive të përbashkëta të identifikuara bëjnë pjesë: mungesa e kulturës së vullnetarizmit, mungesa e organizatave ndërmjetëse dhe pengesat ligjore. Gjatë zhvillimit të Analizës së Nevojave, politikëbërësit duhet të kenë parasysh faktorë si: profili i vullnetarizmit, konteksti kulturor, konteksti politik, mjedisi rregullativ, infrastruktura për punë vullnetare, qëllimet e një ligji ose politike mbi vullnetarizmin, iniciativat e kaluara dhe dimensionin gjinor dhe grupet e marginalizuara.

Suksesi ose dështimi i ligjeve dhe politikave mbi vullnetarizmin është ngushtë i lidhur me vetë vullnetarët dhe organizatat që përfshijnë vullnetarët në aktivitetet e tyre, dhe shumë pak varet nga qytetarët qeveritarë. Prandaj, konsultimi i aktorëve relevantë përgjatë procesit të planifikimit, hartimit dhe zbatimit të ligjeve dhe politikave mbi vullnetarizmin është një domosdoshmëri. Disa nga teknikat e më të zakonshme të një procesi pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës janë: themelimi i grupeve punuese me pjesëmarrjen e të gjithëve, konsultimet individuale, konsultimet e gjera publike, shfrytëzimi i mediave sociale dhe internetit dhe fushata mediale.

Varësisht nga qëllimet dhe sfidat e përcaktuara, politikëbërësit mund të vendosin nëse do të miratojnë një ligj, një politikë, ose të dyja bashkë, për promovimin dhe zhvillimin e vullnetarizmit. Ligjet dhe politikat mund të jenë qendrore ose lokale, ndërsa hartimi i tyre realizohet në mënyrë më të suksesshme për grupeve të përbashkëta punuese (zyrtarë të qeverisë, shoqëria civile, përfaqësuesit e komunitetit, sektori i biznesit).

Përfundimisht, pasi ligji ose politika të jenë miratuar, zyrtarët qeveritarë dhe aktorët tjerë duhet që bashkërisht të zhvillojnë një Plan të Veprimit për zbatim efektiv të ligjit/politikës, duke ofruar udhëzime praktike për aktivitetet, qëllimet, përgjegjësitë dhe afatet e zbatimit. Ky veprim do të sigurojë ndjenjë të përkatësisë dhe përgjegjësisë për të gjithë aktorët dhe do të sigurojë që ligjet dhe politikat mbi vullnetarizmin janë më shumë se fjalë të bukura në letër. Pjesë e rëndësishme e

këtij veprimi është monitorimi dhe vlerësimi i përhershëm i zbatimit të ligjeve dhe politikave, për të sugjeruar ndryshime dhe përmirësime në fushat problematike të zbatimit.

Raste studimi

Ekzistojnë katër modele të vullnetarizmit, të identifikuar nga Archambault, të cilët kanë ndikim mbi kornizën konceptuale dhe operacionale të vullnetarizmit në shumë shtete të Evropës. Një model i pestë është shtuar rishtazi, i cili është relevant për shtetet e ish Bashkimit Sovjetik:

- Në modelin Rhine (Austria, Belgjika, Franca, Gjermania dhe Holanda), sektori i vullnetarizmit shquhet me prezencën e organizatave institucionale dhe profesionale, të cilat veprojnë në fusha të ndryshme (kryesisht argëtim, kulturë dhe përkujdesje sociale) në bazë të përkatësisë fetare, politike apo sindikale,
- Në modelin liberal (Irlanda dhe Britania e Madhe), sektori i vullnetarizmit ka një rëndësi shumë të fortë simbolike, që i ka rrënjët në parimet e krishterimit socialist të shekullit 19 për të promovuar një ndjenjë të fortë përgjegjësie sociale në mes të klasës së mesme, të lidhur me nocionet e klasës punëtore mbi kulturën kooperative dhe vetë-mjaftueshmëria shoqërore. Këto aktivitete filantropike janë shpesh të organizuara individualisht apo lokalisht, në kundërshtim me ato që promovohen nga qeveria federale (si në SHBA) ose si pjesë e aktiviteteve të përbashkëta të organizuara në bashkëpunim me komunitetet lokale (në Evropë),
- Modeli social-demokratik (Finlanda, Norvegjia dhe Suedia) është i bazuar në një traditë shumë të fortë asociative, e cila më tepër mbështetet mbi rëndësinë e intervenimit të vetëm sesa në përkatësinë ideologjike-fetare,
- Modeli mesdhetar (Greqia, Italia, Portugalia dhe Spanja) pasqyron zhvillimin e shpejtë të sektorit të vullnetarizmit në dekadat e fundit, kryesisht si pasojë e mungesës së fondeve publike. Pavarësisht ndryshimeve të fundit, sektori vazhdon të jetë i ndikuar fuqishëm nga roli predominant i Kishës Katolike.
- Modeli i pestë lidhet me kulturën në rritje të vullnetarizmit, e cila shfaqet në ish shtetet Sovjetike (komuniste). Në këtë model, vullnetarizmi, në veçantë në trashëgimi kulturore, është në nivel fillestar për shkak të faktorëve të ndryshëm. Kushtet e vështira ekonomike nënkupton që njerëzit duhet të punojnë më gjatë, shpesh më shumë se një punë, duke e shkurtuar kështu kohën e nevojshme për veprimtari vullnetare.

Italia

Ndonëse legjislacioni mbi fushën e kulturës e përmend vullnetarizmin, ky fenomen ka arritur të jetë relevant vetëm në dekadat e fundit, dhe atë jo vetëm si pasojë e rritjes së sasisë së aktiviteteve vullnetare, por edhe si pasojë e cilësisë së lartë të këtyre aktiviteteve. Nevoja për mirëkuptim dhe bashkëpunim më të thellë mes organizatave vullnetare dhe institucioneve të trashëgimisë kulturore po artikullohet gjithnjë e më fuqishëm në Itali. Organizatat vullnetare janë duke lëvizur drejt kërkesës për t'u njohur si partnerë aktiv në procesin e politikave, vendimeve dhe projekteve që lidhen me fushën e aktivitetit të tyre.

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe në veçanti gjatë viteve të 60-ta të shekullit 20, shoqëria civile italiane e artikuloi fuqishëm nevojën për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga shkatërrimi i jashtëzakonshëm që shkaktohej nga zhvillimi i pakontrolluar ekonomik. Gjatë atyre viteve u themeluan shumë organizata, si Italia Nostra, Grupi i Arkeologëve Italianë, Fondi

Italian për Mjedisin, Federata e Miqve të Muzeve, etj. Përkundër ekzistimit të disa formave të koordinimit, bashkëpunimi zyrtar në mes të vullnetarëve dhe sektorit publik filloi më 1991, kur u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit Ministri e Kulturës – Qendra Kombëtare e Vullnetarizmit. Kjo marrëveshje paraqet rezultatin konkret të një qasjeje të re të administratës publike ndaj menaxhimit të trashëgimisë kulturore, që dallohet me njohjen e rolit që vullnetarët mund ta luajnë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në një situatë kronike të mungesës së fondeve dhe menaxhimit të vështirë dhe të dobët të objekteve dhe monumenteve të trashëgimisë.

Gjermania

Sektori kulturor në Gjermani është i ndarë në një sektor publik të karakterizuar me profesionalizëm dhe një sektor privat të karakterizuar me vullnetarizëm. Derisa muzetë e vogla, private gjithmonë kanë qenë të varur nga vullnetarët, veprimtaria vullnetare në muzetë e mëdha është një fenomen i vonshëm. Që nga vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, muzetë janë ballafaquar me shkurtime buxhetore dhe në të njëjtën kohë, politika dhe shkenca rizbuluan rolin dhe rëndësinë e qytetarisë aktive. Që të dyja këto çështje kanë ndikuar në rritjen e interesimit për vullnetarizëm edhe në kuadër të muzeve të mëdha, të cilët, deri atëherë, mbështeteshin eksklusivisht tek profesionistët e muzeve dhe fondet publike.

Britania e Madhe

Vullnetarizmi ka një traditë të gjatë në Britaninë e Madhe dhe qëndron mjaft mirë në shumë fusha, përfshi shëndetësinë, mirëqenien sociale, sportin, rininë dhe sektorin e kulturës. Puna vullnetare gëzon përkrahje dhe pranim të gjerë si nga publiku ashtu edhe nga autoritetet vendimmarrëse. Besohet se vullnetarizmi është një nga shtytësit më efektiv të shoqërisë civile në Britaninë e Madhe, duke i siguruar themelet e shoqërisë së hapur të lirë dhe me qytetari aktive. Ndonëse vullnetarizmi është mjaft i përhapur në sektorin kulturor, nuk ekziston ndonjë rrjet formal i organizatave vullnetare të trashëgimisë. Shumë organizata ombrellë fokusohen në vullnetarizmin përbrenda fushës së tyre të ngushtë. Kontributi më i madh në këtë fushë jepet nga Këshilli i Muzeve, Librarive dhe Arkivave, agjencia shtetërore e Britanisë së Madhe për muzetë, galeritë, libraritë dhe arkivat, duke ofruar lidhshmëri strategjike dhe partneritet në tërë ishullin.

Iniciativat rajonale dhe globale

Në nivel evropian, roli i vullnetarizmit kohëve të fundit ka fituar mjaft në rëndësi, si një mundësi për zgjidhjen e problemeve të vështira: në fakt, vullnetarët janë të angazhuar në një sërë aktiviteteve të ndryshme, duke filluar nga ofrimi i shërbimeve edukative dhe sociale, avokimi, menaxhimi, deri tek veprimi komunitar dhe mjedisor. Brenda BE-së, janë ndërmarrë disa hapa në njohjen e vlerës sociale, kulturore dhe mjedisore të vullnetarizmit dhe në përfshirjen e organizatave vullnetare në proceset e vendimmarrjes politike.

“Rezoluta mbi Vullnetarizmin” e miratuar nga Parlamenti Evropian më 1983 e njohu natyrën e interesit të përgjithshëm të veprimtarisë vullnetare, që zhvillimi i një infrastrukture adekuate është qenësore për politika efektive të vullnetarizmit, dhe i bëri thirrje Komisionit Evropian t’i kushtojë vëmendje dhe kujdes sistematik vullnetarizmit. Rezoluta bëri thirrje për një “status për punën vullnetare” për t’i mbuluar shpenzimet dhe sigurimin social për vullnetarët. Deklarata 38 mbi aktivitetet e shërbimit vullnetar, e aneksuar në Traktatin e Amsterdimit, e njeh dhe e vlerëson

kontributin e rëndësishëm të aktiviteteve dhe shërbimeve vullnetare për zhvillimin e solidaritetit social, si dhe Komunikata e vitit 1997 e Komisionit Evropian për Promovimin e Rolit të Organizatave dhe Fondacioneve Vullnetare në Evropë thekson rolin e rëndësishëm të vullnetarizmit në krijimin e vendeve të punës. Rishtazi, Komisioni Evropian në një seri dokumentesh ka vlerësuar rëndësinë e një kulture të konsultimit dhe dialogut me organizatat e shoqërisë civile. Një tjetër dokument i rëndësishëm është edhe Deklarata mbi Rolin e Organizatave Vullnetare në Fushën e Trashëgimisë Kulturore, e miratuar nga ministrat përgjegjës për trashëgiminë kulturore të shteteve nënshkruese të Konventës Kulturore të Evropës.

Megjithatë, mbetet shumë punë për të bërë në mënyrë që të afirmohet dhe pranohet gjerësisht vlera ekonomike e vullnetarizmit, në mënyrë që fondet, politikat dhe programet e BE-së të jenë përkrahëse dhe kompatible me nevojat e vullnetarizmit dhe për të krijuar një infrastrukturë adekuate përgjatë Evropës në përkrahje të veprimeve vullnetare. Shumë shtete nuk e përfshijnë vullnetarizmin dhe të dhënat mbi punën vullnetare në statistikat e tyre kombëtare: ndonëse vullnetarizmi nuk nënkupton dhe nuk duhet të nënkuptojë zëvendësim për punën e paguar rregullisht, ai kontribuon ndjeshëm në qëndrueshmërinë e ekonomive kombëtare. Sipas të dhënave më të reja, miliona qytetarë të Evropës janë të përfshirë aktivisht në aktivitete vullnetare:

- Në Britaninë e Madhe, rreth 23 milionë qytetarë marrin pjesë në aktivitete vullnetare çdo vit, duke ofruar një forcë pune ekuivalente me 180,000 të punësuar me orar të plotë. Vlera ekonomike e vullnetarizmit zyrtar është rreth 8% i BPV-së së Britanisë së Madhe,
- Belgët i kushtojnë 5 orë në javë punës vullnetare pa pagesë, që është ekuivalent me rreth 200,000 të punësuar me orar të plotë,
- Në Francë, koha e kushtuar aktiviteteve vullnetare në vitin 2002 ishte ekuivalente me 716,000 të punësuar me orar të plotë,
- Në Poloni, më 2004, rreth 5.4 milionë qytetarë (18.3% i popullatës) kanë marrë pjesë në aktivitete vullnetare. Vlera e përafërt ekonomike e këtij kontributi vullnetar është 124 milionë euro,
- Në Gjermani, 23 milionë qytetarë (36% i popullatës) janë të përfshirë në aktivitete vullnetare,
- Derisa 33% i popullatës së rritur irlandeze janë të angazhuar në punë vullnetare.

III. SUGJERIME PRAKTIKE

Politikat dhe legjislacioni

Vullnetarizmi është një fushë e nën-rregulluar në legjislacionin dhe politikat shtetërore të Kosovës. Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë trajton në mënyrë të përgjithshme vullnetarizmin tek të rinjtë, ndërsa atë e përkufizon si “veprimtari e rinisë e organizuar nga Institucioni përkatës, ku të rinjtë vullnetarisht ofrojnë kohën, punën, njohuritë, aftësitë e tyre pa pagesë apo shpërblim, në shërbim të komunitetit, për të mirën e shoqërisë. Puna vullnetare e rinisë do të njihet si përvojë pune nga Drejtoria Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport përkatësisht Ministria. Dëshminë për këtë e lëshon Institucioni përkatës” Ndonëse ligji përmend edhe njohjen e vullnetarizmit si përvojë pune, e tëra që specifikohet është obligimi për “zhvillimin e procedurave dhe kriterëve për avancimin dhe njohjen e punës

vullnetare dhe të formave të tjera të veprimtarive të rinisë”. Më tutje, neni mbi punën vullnetare të të rinjve, përcakton parimet e përgjithshme të punës vullnetare, ndërsa obligon Ministrinë përkatëse për nxjerrjen e një akti nënligjor për zbatimin e këtyre parimeve. Në udhëzimin administrat për punën vullnetare të të rinjve, të nxjerrë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve përcaktohen obligimet e vullnetarit dhe organizatës që angazhon vullnetarin, nuk specifikohet mënyra e njohjes së punës vullnetare si përvojë pune, kufizohet mosha e vullnetarit (15 – 24 vjeç), dhe parashihet themelimi i Komisionit për zbatimin e punës vullnetare të të rinjve.

Legjislacioni kosovar ka të meta serioze strukturore në drejtim të promovimit, zhvillimit dhe njohjes së punës vullnetare. Të metat kryesore janë:

- Mungesa e një ligji ose politike gjithëpërfshirëse për vullnetarizmin,
- Reduktimi i vullnetarizmit vetëm tek të rinjtë, duke i përjashtuar grup-moshat e tjera,
- Përkufizimet e përgjithshme të parimeve të vullnetarizmit të të rinjve,
- Mosfunksionalizimi i Komisionit për zbatimin e punës vullnetare të të rinjve,
- Mungesa e sinkronizimit të parimeve ekzistuese mbi vullnetarizmin e të rinjve me ligjet dhe politikat e tjera,
- Dhe mbi të gjitha, mungesa e një analize gjithëpërfshirëse për zhvillimin e vullnetarizmit.

Pasi që Kosova nuk ka kornizë të zhvilluar ligjore për promovimin dhe zhvillimin e vullnetarizmit, politikëbërësit duhet të aplikojnë qasjen katër-parimëshe, duke filluar nga veprimet elementare deri në fazën e konsoliduar të zbatimit të legjislacionit për vullnetarizëm. Këto katër parime themelore për krijimin e një kornize legjislative të suksesshme përfshijnë: identifikimin e qëllimeve dhe sfidave/pengesave për ligjet dhe politikat mbi vullnetarizmin, aplikimin e një procesi pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës, hartimin dhe avokimin dhe zbatimin.

Në fazën fillntare sugjerohet zhvillimi i një analize të përgjithshme për të përcaktuar qëllimet dhe sfidat e legjislacionit për promovimin e vullnetarizmit, ndërsa rezultat e këtij procesi duhet të jetë dokumenti i Vlerësimit të Nevojave. Në përcaktimin e qëllimeve të përgjithshme të legjislacionit dhe politikave mbi vullnetarizmin duhet të merren parasysh këto qëllime:

- Mobilizimi i qytetarëve për arritjen e qëllimeve zhvillimore – një nga qëllimet themeloretë ligjeve dhe politikave të vullnetarizmit është mobilizimi i qytetarëve për të përkrahur zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe politik përmes iniciativës individuale dhe të organizatave,
- Përkrahja e fushave prioritare të qeverisë – në kontrast me mobilizimin e përgjithshëm të qytetarëve në përkrahje të zhvillimit, disa praktika sugjerojnë shfrytëzimin e iniciativave vullnetare për të adresuar prioritetet specifike qeveritare,
- Krijimi i mekanizmave reagues ndaj fatkeqësive – në përpjekje për të menaxhuar dhe rritur efikasitetin e vullnetarëve në përprahje të reagimit ndaj fatkeqësive, shumë shtete kanë miratuar ligje dhe politika që synojnë krijimin e mekanizma permanentë vullnetarë për reagim ndaj fatkeqësive,
- Promovimi i aktivizmit qytetar – disa praktika dëshmojnë se shtetet kanë miratuar ligje dhe politika mbi vullnetarizmin për të nxitur ndjenjën e aktivizmit qytetar. Dy shembuj të mirë të kësaj praktike mund të gjenden në kuadër të iniciativave ECOWAS (Komuniteti Ekonomik i Shteteve të Afrikës Perëndimore) dhe RIVER SEE (Integrimi rajonal përmes Shkëmbimit të Vullnetarëve për Pajtim në Evropës Juglindore),
- Zhvillimi ekonomik – shumë shtete shfrytëzojnë ligjet dhe politikat mbi vullnetarizmin për të zhgjidhur probleme ekonomike dhe promovuar zhvillimin ekonomik. Në vitin 2009, Britania e Madhe ka alokuar mbi 42 milion funte për OshC-të që u ndihmojnë njerëzve të prekur nga kriza e fundit financiare globale, në mënyrë që të promovohet puna vullnetare në mesin e të papunëve.

Në përcaktimin e sfidave/pengesave kryesore të legjislacionit dhe politikave mbi vullnetarizmin duhet të merren parasysh këto sfida:

- Mungesa e kulturës së vullnetarizmit – në vendet ku vullnetarizmi nuk kuptohet si duhet ose nuk shihet si i rëndësishëm nga popullata, ligjet dhe politikat mbi vullnetarizmin mund të dështojnë ose të zbatohen dobësisht,
- Mungesa e organizatave ndërmjetëse – iniciativat e suksesshme vullnetare kërkojnë pjesëmarrje nga dhe partneritet mes qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit të biznesit. Një numër i konsiderueshëm shtetesh kanë krijuar grupe punuese të nivelit qendror, derisa një numër shtetesh kanë preferuar themelimin e qendrave kombëtare ose lokale të vullnetarizmit, duke i sjellë nën një kulm vullnetarët, organizatat që angazhojnë vullnetarë dhe zyrtarët qeveritarë,
- Pengesat ligjore – politikëbërësit duhet të shqyrtojnë një numër të konsiderueshëm ligjesh dhe politikash për të parë nëse ato krijojnë pengesa të panevojshme për vullnetarizmin. Në shumë shtete, ligjet që ndikojnë më së shumti në punën vullnetare nuk janë ligjet mbi vullnetarizmin, por provizionet që gjenden në ligjet e punës, tatimore, sigurimeve sociale, emigracionit, përgjegjësisë civile, etj.

Proceset pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse që përfshijnë të gjithë aktorët – përfshi shoqërinë civile, vullnetarët, akademikët, qeverinë dhe sektorin e biznesit – promovojnë ndjenjën e përkatësisë dhe përkushtimit ndaj iniciativave vullnetare që do të ndikohen në masë të madhe nga ligjet dhe politikat e reja. Qeveria duhet të sigurojë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve në të gjitha etapat e iniciativës për reformë, përfshi planifikimin, hartimin dhe zbatimin e një ligji ose politike. Pjesëmarrja e gjerë mundëson zhvillimin e ligjeve dhe politikave më cilësore. Përfshirja e të gjithë aktorëve ndihmon në identifikimin e prioriteteve dhe qëllimeve dhe mundëson një hartim më efikas të ligjit ose politikës. Për më tepër, përmes përfshirjes së gjerë, politikëbërësit mund të përfitojnë nga përvoja e organizatave dhe vullnetarëve të cilët preken nga ligjet dhe politikat.

Disa nga teknikat e më të zakonshme të një procesi pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës janë:

- Themelimi i grupeve punuese me pjesëmarrjen e të gjithëve – sugjerohet që Grupi Punues të përbëhet nga përfaqësues të Ministrive që preken nga vullnetarizmi, OSHC-të, anëtarë të Kuvendit të Kosovës, akademikë, dhe të tjerë,
- Konsultimet individuale – cilësia e ligjeve dhe politikave do të jetë më e madhe në rast se gjatë procesit konsultohen edhe ekspertë të pavarur dhe zyrtarë të Ministrive,
- Konsultimet e gjera publike – publiku i gjerë duhet të jetë pjesë e procesit përmes tryezave të diskutimit
- Shfrytëzimi i mediave sociale dhe internetit – në vendet ku përdorshmëria e internetit është e gjerë, procesi i konsultimeve duhet të shfrytëzojë edhe mekanizmat virtualë të vetëdojesimit dhe përfshirjes së publikut, dhe
- Fushata mediale – përdorimi strategjik i mediave mund të ndikojë ndjeshëm në rritjen e vetëdijes së publikut mbi vullnetarizmin, ligjet, politikat dhe qëllimet e tyre.

Hartimi i ligjeve/politikave

Një ngapyetjet preliminare është nëse vullnetarizmi duhet të rregullohet përmes një ligji, rregullative apo politike. Ligjet, në parim duhet të adresojnë çështjet ligjore që ndikojnë në vullnetarizmin, si psh. eliminimi i pengesave në legjislacionin aktual dhe njohja ligjore e punës vullnetare. Në anën tjetër, një politikë qeveritare është një udhëzues i mirë për burrokracinë shtetërore dhe publikun rreth zotimeve të qeverisë për përkrahjen dhe zhvillimin e vullnetarizmit në vend. Politikat mbi vullnetarizmin gjithashtu ndihmojnë në edukimin e publikut rreth vullnetarizmit dhe sigurojnë përkrahje dhe vullnet politik për reforma cilësore dhe vizionare. Sugjerohet që politikat qeveritare të pasojnë ligjin mbi vullnetarizmin dhe të jenë udhërrëfyes për burrokracinë shtetërore mbi zbatimin adekuat dhe efikas të ligjit.

Ligjet dhe politikat qendrore përmbajnë parimet e përgjithshme të vullnetarizmit dhe ofrojnë drejtime për zhvillimin dhe promovimin e vullnetarizmit. Politikat qendrore mund të kenë për qëllim edhe promovimin e vullnetarizmit në fusha të caktuara – rini, arsim, kulturë, mirëqenie sociale, shëndetësi – dhe zakonisht shfrytëzohen për të rritur bashkëpunimin mes institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, sektorit të biznesit dhe vullnetarëve. Këto politika mund të miratohen për gjithë qeverinë ose për ministri të caktuara. Derisa në Kosovë ekziston një politikë qeveritare për vullnetarizmin e të rinjve (ndonëse mjaft e përgjithësuar), ajo dhe politikat e tjera sektoriale, duhet të dalin si rezultat i një procesi gjithëpërfshirës të analizës për zhvillimin dhe promovimin e

vullnetarizmit në Kosovë dhe të jenë në harmoni me një ligj ose politikë të përgjithshme shtetërore mbi vullnetarizmin. Ekzistojnë modele të ndryshme të hartimit të politikave të vullnetarizmit, si psh. hartimi i një politike që adreson papunësinë tek të rinjtë nga Ministria e Punës apo Ministria e Rinisë, ose hartimi i një politike për lehtësira tatimore për vullnetarët nga autoriteti tatimor i shtetit. Në raste të tjera, ligjet dhe politikat mund të iniciohen nga Kuvendet, ose mund të jenë të shkruara nga OshC-të dhe dërguara në institucionet shtetërore për procedim të mëtutjeshëm. Pa marrë parasysh iniciuesin, natyrën, nivelin dhe substancën e një ligji ose politike mbi vullnetarizmin, shtetet me iniciativat më të suksesshme janë ato që kanë themeluar grupe multi-sektorale punuese për të siguruar hartim substancial dhe mobilizuar përkrahje publike, kohë të mjaftueshme për vlerësim të procesit të vendim-marrjes dhe lobimit, dhe plane të detajuara të zbatimit dhe monitorimit të politikave.

Qeverisë dhe OshC-ve u sugjerohet që të themelojnë një Grup Punues të aktorëve relevantë, që do të jetë përgjegjës për hartimin e ligjit dhe politikave. Aktorët që duhet të jenë pjesë e këtij Grupi Punues janë: ministritë relevante, autoritetet rregullative, Zyra e Kryeministrit, OshC-të, vullnetarët, akademikët, ekspertët ligjorë, sektori i biznesit dhe përfaqësuesit e komuniteteve. Elementet që duhen marrë parasysh gjatë hartimit të një ligji nga ky Grup Punues janë: qëllimi, denificionet, provizionet operacionale, provizionet e kompatibilitetit dhe zbatimit, provizionet kalimtare dhe data efektive e hyrjes në fuqi. Në anën tjetër, politikat mund të përmbajnë të gjitha këto elemente, si dhe këto në vijim: analizë e situatës, parimet udhëheqëse dhe qëllimet e veprimit qeveritar, monitorimi dhe vlerësimi, plani i zbatimit.

Zbatimi i ligjeve/politikave

Pa plane të qëndrueshme dhe efektive të zbatimit, ligjet dhe politikat do të mbeten vetëm në nivel të dëshirave. Planet për zbatim efektiv duhet të jenë pjesë përbërëse e procesit të hartimit të ligjeve dhe politikave. Një Plan i suksesshëm duhet të konsiderojë këto elemente: aktivitetet, qëllimet, përgjegjësitë, afatet e realizimit dhe monitorimi. Për këtë qëllim sugjerohet themelimi i një mekanizmi të përbashkët koordinues në nivel qendror. Kjo agjenci shtetërore do të jetë përgjegjëse për zbatimin efektiv të ligjeve dhe politikave mbi vullnetarizmin, ndërsa në përbërjen e saj duhet të përfshihen zyrtarë qeveritarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

